



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:079465
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06227405

Ac.nr.34/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Sh., nga fshati P., Komuna e Ferizaj, me përfaqësuesin ligjor B.Sh., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson J.B., avokat në Ferizaj, kundër të paditurës Q.T. E.T.C. (E.G.) Sh.P.K., me seli në Pejë, Z.I., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.A., juriste tek e paditura, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe të paditurës, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.373/18, të datës 09.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Q.T. E.T.C. (E.G.) Sh.P.K., me seli në Pejë, si dhe ankesa e paditësit E.T., nga fshati P., Komuna e Ferizajit, ashtu që **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.373/18, i datës 09.11.2020, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.373/18, të datës 09.11.2020, ka vendosur si vijon: "I. **MIRATOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve E.Sh. nga fshati P. Komuna Ferizaj, dhe **DETYROHET** e paditura Q.T.E.T.C. (E.G.) sh.p.k. me seli në Pejë, Z.I., që paditësit t'ia kompensoj dëmin material dhe jo material me rastin e lëndimit në këndin e lojërave me datë 02.09.2017, me çrast paditësit kishin pësuar lëndime të rënda trupore, andaj duhet ti kompensohet dëmi në këto baza: a. Në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material: për të gjitha format e dhimbjeve fizike shumën prej 2,000.00 €; për friken e përjetuar shumën prej 800.00 €; për shëmtim trupor 3,000.00 €; për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 4,000.00 €; b. Në emër të kompensimit të dëmit material: për kujdesin nga personi i tretë në shumën prej 500.00 €; për ushqim të përforcuar 300.00 €; për rehabilitim fizik shumën prej 1,000.00 €; për shpenzime të shërimit 2,000.00 €; Gjithsej dëmi jo material në shumë prej

13,600.00 €; Gjithsejtë dëmi jo material dhe material për të gjithë të paditurit Erion Shatrolli, është aprovuar në shumën prej 13,600.00 €, (tremb dhjet mijë e gjashtëqindën euro). Të gjitha me kamate prej 8% duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare, nënë kanosjen e përmbarimit të dhunshëm; II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit për tej shumave të gjykuara si në dispozitivin I. dhe atë lidhur me kërkesën në emër të dhimbjeve fizike, ushqimit, ndihmës së huaj si dhe rehabilitimin fiziatriko-psikik në shumën prej 28,450.00 € (Njëzet e tetëmijë e katërqindën e pesëdhjetë euro); III. DETYROHET e paditura që në emrin e shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe atë për taksën gjyqësore në shumën prej 21.00 €, përpilimin e padisë 208.00 €, për përfaqësim për 9 seanca gjyqësore nga 270.00 € x 6 = 2,433.60 €, për ekspertizat mjekësore shumën prej 950.00 €, në shuma e përgjithshme prej 3,312.60 € të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm; IV. OBLIGOHEN paditësit që të paguajnë shpenzimet për taksën gjyqësore shtesë në shumën prej 80.00 €, pas pranimit të këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që të caktohet kompensimi i dëmit material dhe jo material në shumën e kërkuara nga paditësi ose aktgjykimi i atakuar të prishet për pjesën refuzuese dhe çështja t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu, kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë edhe e paditura, përmes përfaqësueses së saj, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 pika c) për të Ligjit për Procedurën Kontestimore (këtu e tutje LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit dhe e të paditurës janë të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 20.04.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 30.06.2022, duke kërkuar kompensim për dëmin jo material në emër të zvogëlimit të aktiviteti të përgjithshëm jetësor, dhimbjeve fizike, frikës dhe shëmtimit, si dhe kompensim për dëmin material në emër të ndihmës së huaj, rehabilitimit klimaterik, ushqimit të përforcuar dhe shpenzimeve të shërbimit, në shumën e përcaktuara si në këtë parashtrësë, dëm ky të cilin pretendon se i është shkaktuar si pasojë e lëndimit të paditësit në këndin e lojërave të paditurës, si dhe ka kërkuar aplikimin e kamatës ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe ndër të tjera ka theksuar se ndonëse në përgjigje në padi nuk ka

mohuar faktin se paditësi është lënduar në këndin e lojërave, pas deklarimit të punëtorëve të angazhuar, për të paditurën ky fakt është bërë kontestues, andaj ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.373/18, të datës 09.11.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë pas përmbledhjes së deklaratave të ekspertëve, ekspertizave të tyre, dhe deklaratave të dëshmitarëve, ka theksuar se deklaratave të dëshmitarëve të dorëzuara nga ana e të paditurës, nuk ua ka falur besimin. Në anën tjetër, gjykata ka theksuar se sa i përket lartësisë së shumave të aprovuara për kategori të ndryshme të dëmit si në dispozitivi të aktgjykimit të atakuar, është bazuar në ekspertizën e ekspertit mjekësor ortoped – traumatolog, si dhe ekspertit mjekësor të psikiatrisë. Sipas gjykatës së shkallës së parë shuma më të larta se ato të gjykuara nuk kanë mbështetje në vlerësim, real të dëmit jo material. Tutje, gjykata në arsyetim ka vlerësuar se ekspertizat nga lëmia e mbrojtjes dhe sigurisë në punë lidhur me përgjegjësinë primare dhe sekondare, kanë qenë pjesërisht të bazuara meqë janë marrë parasysh këto pretendime me rastin e vendosjes. Vendimin për kumatën ligjore gjykata e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e arsyetoi konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së (*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore nga neni 182 paragraf 2, pika (n) i LPK-së, lidhur me nenet 182.1 dhe 160 të LPK-së, meqë ka të meta në atë mënyrë që faktet vendimtare lidhur me themelësinë e kërkesëpadiës së paditësit nuk janë vërtetuar dhe arsyetuar në masën e duhur dhe të mjaftueshme, për çka edhe është bërë vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike, si rezultat i së cilës nuk është bërë zbatimi i duhur i të drejtës materiale për të cilën shkelje gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të bazuara pretendimet e palës së paditur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që gjykata nuk ka arsyetuar faktet vendimtare në të cilat është bazuar për vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadiës. Kjo sepse fillimisht gjykata e shkallës së parë në pjesën dërrmuese të arsyetimit të aktgjykimit të atakuar përmbledh kërkesëpadinë dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, deklaratat e dëshmitarëve dhe vet palëve, si dhe deklaratat e eksperteve, duke i gërshetuar ato me konstatimet e ekspertëve në ekspertizat e tyre. Tutje, gjykata e shkallës së parë ndonëse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka shtjelluar deklaratën e përfaqësuesit ligjor të paditësit, e njëjta këtë deklaratë nuk e ka vlerësuar, pasi që nuk ka konstatuar nëse të njëjtës ia ka falur apo jo besimin, madje as nuk ka theksuar fare se as cilat fakte vendimtare gjykata i ka vërtetuar përmes kësaj deklarate. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, duke mos arsyetuar vlerësimin e saj, i ka konsideruar si pjesërisht të bazuara ekspertizën e ekspertit H.H., atë të ekspertit I.Sh., si dhe ekspertizën e grupit të ekspertëve A.K., H.N. dhe S.K., të gjithë ekspert nga lëmia e

Mbrojtjes dhe Sigurisë në Punë. Përkatësisht, gjykata nuk e ka bërë të qartë se cilës nga këto ekspertiza ia ka falur besimin dhe cilës jo. Duke qenë se përmes këtyre ekspertizave janë nxjerrë mendime lidhur me bazën ligjore të përgjegjësisë për lëndimin e paditësit, rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye lidhur me përgjegjësinë për lëndimin e paditësit, me të cilën kushtëzohet e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar, e që në rastin konkret është parakusht për vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadisë. Madje, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare as pretendimet e palës së paditur, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me faktin kontestues të përgjegjësisë së kësaj të fundit për lëndimin që i është shkaktuar palës paditëse. Në anën tjetër, për Gjykatën e Apelit ishte po ashtu e pa qartë llogaritja e lartësisë së shumave për kompensimin e kategorive të ndryshme të dëmit, për shkak se arsyetimi i aktgjykimit të atakuar nuk përmban shpjegime lidhur me shkallën e përgjegjësisë, përkatësisht gjykata nuk ka potencuar nëse në llogaritjen e lartësisë së shumave të aprovuara ka marrë për bazë apo jo kontributin eventuale të paditësit në shkaktimin e lëndimit.

Prandaj, Gjykatës së Apelit i rezultoi se marrja e një aktgjykimi të tillë nga gjykata e shkallës së parë është bërë duke mos e vërtetuar plotësisht gjendjen faktike, gjegjësisht duke mos dhënë vlerësimet e duhura për deklaratat e ekspertëve dhe pretendimet e palëve. Për Gjykatën e Apelit është e pa qartë se në cilën ekspertizë është mbështetur gjykata e shkallës së parë lidhur me përgjegjësinë e të paditurës për shkaktimin e lëndimit të paditësit, si dhe si gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë të paditurës dhe kontributin e paditësit në shkaktimin e lëndimit. Po ashtu, gjykata nuk dhënë vlerësime lidhur me faktin kontestues nëse në kohën kur ka ndodhur lëndimi i paditësit ka ekzistuar rregullorja përmes së cilës prindërve ose kujdestarëve të fëmijëve u lejohej që të futën brenda në këndin e lodrave për përkujdesjen e fëmijëve, ashtu siç pretendon e paditura, apo ka ekzistuar vetëm njoftimi me të cilin i ndalohej hyrja e prindërve brenda kindit të lodrave, ashtu siç pretendon pala paditëse. Andaj, nga analizimi i provave shkresore që ka administruar gjykata e shkallës së parë, po ashtu dhe dëgjimit të palëve, Gjykata e Apelit vlerësoi së gjendja faktike nuk është vërtetuar në masën e duhur, duke mos u vërtetuar fakte esenciale që kanë ndikim në zgjidhjen e drejtë të këtij rasti.

Si pasojë e vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike për shkak të mos vërtetimit të gjitha fakteve vendimtare, kjo gjykatë i vlerëson si të bazuara pretendimet ankimore në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit vlerëson se gjatë procedurës nuk është bërë konstatimi i plotë i gjendjes faktike dhe gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha pretendimet që vlerësohen të jenë vendimtare për këtë kontest, ndonëse ka qenë e obliguar të paraqes arsye të duhura përkitazi me faktet që i përkasin kësaj natyre të kontestit, siç është kërkuar nga e paditura, duke bërë referencë në normë materiale, në mënyrë që vendimi të jetë i ligjshëm.

Bazuar në arsyet e paraqitura, aprovohen si të bazuara pretendimet ankimore lidhur me këto shkelje dhe me rastin e marrjes së lëndës në rishqyrtim dhe rivendosje, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të ndër marrë veprime të caktuara për eliminimin e shkeljeve të përmendura si më lartë, në pajtim me dispozitat ligjore. Pas vërtetimit të gjitha fakteve dhe kryerjes së të gjitha veprimeve që i ka për obligim si gjykatë, e njëjta udhëzohet t'i kushtoj kujdes fakteve të ngritura,

ashtu që të arsyetoj vlerësimin e ekspertizave dhe deklaratave të palëve, të konstatoj përgjegjësinë e të paditurës dhe shkallën e saj.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se tani për tani nuk janë krijuar kushtet ligjore që eventualisht aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të mund të ndryshohet, por është dashur që i njëjti të priset dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje, ngase mangësitë procedurale të konstatuara si më sipër kanë qenë bazë e mjaftueshme për një gjë të tillë.

Nga të lartcekurat, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë të i evitohet shkeljet e theksuara më lartë, të arsyetoj vërtetimin e fakteve vendimtare, lidhur me bazën ligjore të përgjegjësisë të paditurës dhe kontributit eventuale të paditësit. Nga vërtetimi i këtyre fakteve, më pas gjykata duhet të ofrojë qëndrime nëse vërtet paditësi ka të drejtë në kompensim të dëmit apo deri në cilën lartësi, nëse provohet se padia është e bazuar. Në fund, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozita e neni 160 të LPK-së (të hartoj dispozitivin e aktgjykimit në përputhje me par. 3 të nenit 160 të LPK-së, si dhe të paraqes arsyetimin në pajtim me par. 4 të këtij neni), ashtu që pas administrimit të provave të propozuara nga të dyja palët ndërgjyqëse dhe vlerësimit të arsyetuar të provave që i shqyrton dhe i administron, dhe pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të vendosë për kërkesëpadinë e palës paditëse. Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të nenit 194 dhe 195, paragraf 1, pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.34/2021, datë 25.09.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci